

P.nr.418/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrat ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit K.D. nga P. për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 tëKPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 3205/16 të datës 17.01.2017, jashtë seancës, me datë 10.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3205/16 të datës 17.01.2017 për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

K.D.,i ati i I. , nënës S., mbiemri i vajzërisë së nënës K.,i lindur mëdt:..., me vendbanim në P., rr.“M.K.”, nr....,me nr.pers.....shqipëtar,- shtetas iRepublikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,me datë 05.06.2016,rreth orës 17:30, në rrugën magjitrare Podujevë-Prishtinë, i pandehuri deri sa ka qenë duke e drejtuar automjetin e tipit “BMW”, me targa të regjistrimit ..., ngjyrë e kuqe , nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 126 par.1 të ligjit për siguri në komunikacion rrugor, duke mos ia përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve në rrugë, duke mos mbajtur distancën e sigurisë në mes të automjeteve, me të arritur mbi urë në fshatin V., i njëjti me pjesën e përparme të automjetit e godet në pjesën e pasme automjetin e tipit “Toyota”, me targa të regjistrimit ..., ngjyrë hiri, të cilin e drejtonte I.G., me ç’rast lëndime të lehta trupore pësojnë tani i dëmtuari: F.D. dhe R.D.,-

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

Nëshumë prej **200(dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se e pandehura nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet:i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **20** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Të dëmtuarit :I.G. nga M. rr.“L.P.”, nr...., F.D., R.D. nga P. rr.“M.K.”, nr....,lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.3205/16 të datës 17.01.2017, kundër K.D. nga P.,për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1të KPRK-së, teakuzuarit sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Ekspertiza e komunikacionit e datës 23.10.2016, Ekspertiza mjeko-ligjore e datës 11.12.2016, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.418/17, të dt. 10.04.2018

Zyrtare Ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.